



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-11629/25 datë:19.05.2025



Npi – 01/205 datë: 29.05.2025

Bazuar në nenin 12 pika 2 shkronja (d), nenin 58 shkronjat (d dhe h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Nenin 14 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës Nr.06/L-084 i dt.27.06.2019; Udhëzimin Administrativ të Qeverisë të Republikës së Kosovës (QRK) Nr.06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës; Rregulloren Komunale për mbrojtjen e fëmijëve numër, Npi – 01/177 datë: 31.08.2020; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Pikës 3 të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/197 të datës 27.05.2025. Duke vendosur lidhur me nevojën për miratimin e Planit të Punës së Ekipit për të drejtat e Fëmijëve 2025-2027, pas procesit të diskutimit publik me qytetarë më datën 22.05.2025, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më 29.05.2025, miratoi:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2025-2027

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 29.05.2025, unanimisht miratoi, Planin e Punës së Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve për periudhën 2025-2027.

II


Plani i Punës së Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve për periudhën 2025-2027, është aprovuar pas procesit të diskutimit publik me qytetarë, si dhe duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/197 të datës 27.05.2025.

III

Ky vendim bashkë me Planin hyjnë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi bashkë me Planin u dërgohen: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi